

Pershendetje

Ne lidhje me kerkesen tuaj per trajtim, strukturat perkatese te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, po ju percjellin materialin, te cilat mbulojne problematikat specifike te shfaqura ne e-mailin e Znj.K..., per aq sa i perket fushes se veprimtarise administrative, dhe pas analizimit te kerkeses ne lidhje me mallrat e blera online, te cilat hyjne nepermjet dergesave postare po ju informojme se:

Në zbatim të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë" nenet 52 dhe 184, VKM nr.651, datë 10.11.2017 "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" nenet 420 deri 424, është miratuar Udhëzimi nr.02, date 15.01.2018 "Udhëzim për deklarimin e mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje "on line" nëpërmjet operatoreve postar", ndryshuar me udhëzimin nr, 02, datë 01.03.2019.

Sipas nenit 420 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017, mallrat me vlerë të papërfillshme janë mallrat e natyrës jo-tregtare vlere e të cilave është nën 22 Euro për blerjet on-line dhe nën 45 Euro për dërgesat postare.

Lidhur me pyetjen e parë:

Në të gjitha rastet kur një individ blen mallra on line në një vend jashtë territorit Shqiptar, çmimi i të cilave është nën 22 Euro (pavarësisht kostos së transportit), ato mallra çlirohen menjëherë, pasi bazuar në nenin 420 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 për këto mallra nuk paguhen detyrime doganore. Këtu bëjnë përjashtim mallrat e parashikuara në nenin 421 të VKM-së (produktet alkoolike, parfumet dhe ujë tualeti, duhanet dhe produktet e duhanit).

Po kështu, në të gjitha rastet kur një individ i dërgohen mallra nga një individ rezident jashtë territorit Shqiptar, çmimi/vlera e të cilave është nën 45 Euro, ato mallra çlirohen menjëherë, pasi bazuar në nenin 422-424 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 për këto mallra nuk paguhen detyrime doganore, duke respektuar kufizimet e parashikuara në nenin 424 të VKM-së.

Nëse mallrat ne një dërgesë postare kanë vlerë më të madhe se 22 Euro apo 45 Euro, atëherë bazë për llogaritjen e detyrimeve doganore është vlere doganore e mallrave e cila përfshin dhe shpenzimet e transportit.

Lidhur me pyetjen e dytë:

Ne Shenimin shtese te meposhtem te Kapitullit 21 te Nomenklatures se Kombinuar te Mallrave, :

6. Pergatitje te tjera ushqimore te paraqitura ne dosa te matshme, te tilla si kapsula, tableta, pastile dhe pilula, dhe qe kane qellim per t'u perdorur si suplemente ushqimore, klasifikohen ne kreun 2106, pervec rasteve kur specifikohen apo perfshihen diku tjeter.

Ne Kreun 2106 suplementet, te cilat nuk jane concentrate proteinash, e kane taksen doganore 2%.

DHL nuk ka gabuar me klasifikimi e mallit apo vendosjen e tarifes doganore, e cila eshte automatike ne momentin e kryerjes se deklarates doganore.

Lidhur me pyetjen e trete:

Për mallrat e natyrës jo tregtare të importuara nga një individ, vlera e të cilave është nga 23 Euro deri 1000 Euro (për blerjet on-line) dhe nga 46 Euro deri 1000 Euro (dërgesat nga individët) përdoret deklarimi i thjeshtuar sipas manualit bashkëlidhur Udhëzimit nr. 2, datë 15.01.2018.

Për të gjithë mallrat e natyrës jo –tregtare vlera e të cilave është mbi 1000 Euro, deklarimi kryhet me deklaratë standarte.

Në të dyja rastet, deklaratë e thjeshtuar apo deklaratë standarte, tarifa e shërbimit të deklarimit nuk varet nga administrata doganore dhe nuk paguhet për administratën doganore. Operatorët postar, në rastin konkret DHL janë persona juridik që kanë objekt të punës së tyre shërbimin e transportit dhe të përfaqësuesit të tërthortë (deklaruesit të mallrave në doganë) i cili vepron në emër të tij por për llogari të pritësit të mallrave (individit). Tarifa e shërbimit të deklarimit është tarifë që vendoset dhe merret nga operatori postar (DHL), jo nga dogana.

Në lidhje me pyetjen e katërt;

Në lidhje me tarifën e shërbimit për deklarimin e mallrave në doganë ju sqaruar në pikën e tretë. Pra kjo tarifë vendoset dhe merret nga operatori postar përkundrejt shërbimit të deklarimit që kryen. Përsa i përket krahasimit të individëve që kryejnë blerje on-line në BE me individët në Shqipëri, ju sqarojmë se ne përgjigjemi vetëm si procedohet aktualisht në kushtet e vëndit tonë.

Por megjithatë ju sqarojmë se në planin dhe objektivat e administratës doganore shqiptare në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është dhe zhvillimi i sistemit informatik dhe lehtësimi i procedurave doganore në përputhje me procedurat në BE për sa i përket tregëtisë on-line dhe jo vetëm.

Lidhur me rastin tuaj:

Vlera e mallrave = 61.37 \$ (me e madhe se 22 Euro)

Vlera transportit = 31.10 \$

Vlera doganore = 61.37 + 31.10 = 92.47 \$

Në këtë rast për llogaritjen e detyrimit doganor merret vlera doganore, pasi çmimi i mallrave të blera është mbi 22 Euro.

Nese mallrat qe keni porositur klasifikohen në një kod 8 shifror sipas NK te Mallrave 2022 i cili ka nivel tarifor 2 %, atëherë baza mbi të cilën llogaritet kjo taksa doganore, është 92.47 \$ e konvertuar me kursin e këmbimit që aplikohet në lekë.

Ndërsa baza për llogaritjen e TVSH (20%) është: 92.47 \$ e konvertuar me kursin e këmbimit që aplikohet në lekë + taksën doganore.

Siç ju kemi sqaruar dhe më sipër kufiri i vlerës së papërfillshme që përjashtohet nga detyrimet doganore në Shqipëri është 22 Euro për blerjet on line dhe 45 Euro për dërgesat nga një individ tjetri, e cila mund të jetë e ndryshme nga ajo e BE-së, dhe si rrjedhojë dhe llogaritja e detyrimeve doganore është e ndryshme. Duhet të informoheni dhe për kufirin e vlerës së papërfillshme ose të pataksueshme që parashikon legjislacioni i BE-së për të bërë krahasimet.

Për administratën doganore paguhet vetëm detyrimi doganor (taksa doganore, nëse ka, dhe TVSH).

Ndërsa tarifa e shërbimit të deklarimit i paguhet operatorit postar, pra është marrëdhënie ndërmjet individit dhe operatorit postar nuk varet nga dogana.